

UDC: 1



ISSN 1857 – 9272 (Print)

PHILOSOPHICA

< International Journal of Social and Human Sciences >

7/2017

PHILOSOPHICA | Vol. 4 | No.7 | PP.1-134 | Tetova, 2017

PHILOSOPHICA
International Journal of Social and Human Sciences

Editor-in-Chief: Vullnet Ameti

Editors: Fadbi Osmani, Ibish Kadriu, Lulzim Mehmedi, Kushtrim Ahmeti

Publisher: Faculty of Philosophy, University of Tetovo, Republic of Macedonia

Editorial Board:

Dario Altobeli (Italy)
Servet Pëllumbi (Albania)
Peter Oni (Nigeria)
Myqereme Rusi (Macedonia)
Ednan Aslan (Austria)
Shinasi Gyndyz (Turkey)
Marenglen Verli (Albania)
Galip Veliu (Macedonia)
Bernd J. Fischer (USA)
Ahmet Alibasic (Bosnia and Hercegovina)
Hajrulla Koliqi (Kosovo)
Fehari Ramadani (Macedonia)
Oliver Leaman (USA)
Alparslan Açikgenç (Turqi)
Boris Manov (Bulgaria)
Rabije Murati (Macedonia)
Leke Sokoli (Albania)
Alenka Bartulovi (Slovenia)
Januz Dervodeli (Kosovo)
Flora Sela Kastrati (Macedonia)
Ilija Aceski (Macedonia)
Ermin Sinanovic (USA)

Editorial Council:

Qani Nesimi (Macedonia)
Zeqirja Rexhepi (Macedonia)
Abdylnaser Sinani (Macedonia)
Enver Halilovic (Bosnia and Hercegovina)
Xheladin Murati (Macedonia)
Andi Pinari (Albania)
Musa Musai (Macedonia)
Vehbi Miftari (Kosovo)
Besa Havziu (Macedonia)
Buniamin Mehmedi (Macedonia)
Ramiz Abdyli (Macedonia)
Milika Dhama (Albania)
Ardita Ceka (Macedonia)
Gazmend Rizaj (Kosovo)
Adnan Ismaili (Macedonia)
Zoran Matevski (Macedonia)
Qerim Dalipi (Macedonia)
Valeria Giannotta (Turkey)
Hiriet Ziberi (Macedonia)

Proofreading: (Albanian, English)

Arbër Çeliku, Nertila Sinani, Bashkim Halili

Philosophica

International Journal of Social
and Human Sciences
ISSN 1857 – 9272 (Print)
Published twice a year
Account No. 160016005478810
Tax No. 4028004139891
Deponent: Narodna Banka na RM
Income Code: 723019
Programme: 43
IBAN: MK07 1007 0100 0066 227
SWIFT: NBRM MK 2X

Technical Editing/Layout:

Kushtrim Arifi

Printing House:

Arbëria Design

Editorial Office:

Office for Scientific Research and
Innovation, University of Tetova
Tetova, Republic of Macedonia
Ilinden, n.n 1200, Tetova
Phone: +389 44 356 500
e-mail: philosophica@unite.edu.mk
URL: www.unite.edu.mk

Përmbajtja

Planifikimi i vlerësimit formativ të të arriturave të nxënësve si etapë e rëndësishme e vlerësimit të standardizuar	10
Valdeta Zenuni-Idrizi & Rina Rushani-Ajdari	
Lifestyle of former NLA soldiers: district of Kumanovo	14
Abdylnaser Sinani & Shaban Neziri	
Ndikimi i familjes dhe shkollës në edukimin e delikuentëve	17
Agim Sallmani & Valdeta Zenuni-Idrizi	
Favorizimet e nxënësve, dëshmi e vështirësisë së integritit në arsimin multikulturor	25
Agron Iljazi & Besjana Rexhepi	
Аудитивно помнење	28
Кескинова Ангелка	
The presence of the film in the societies with cultural diversities	33
Bekim Sele	
Edukimi mediatik, sfidë për demokracinë në shkollat e arsimit bashkëkohor	37
Besjana Rexhepi & Agron Iljazi	
Ndikimi i metodës mësimore të demonstrimit në arritjet e nxënësve në mësim	40
Bujar Adili & Buniamin Memedi	
Reformimi i shkollave fillore në republikën e maqedonisë në periudhën 1996-2016	46
Lulzim Mehmedi	
Vendi dhe roli i kontrollimit dhe notimit në sigurimin e arsimit kualitativ	51
Fadbi Osmani, Svetlana Pandilloska Grnçarovska, Ardita Sylejmani	
Arsimi multikulturor, sfidë për shoqëritë me diversitet kulturor	55
Flora Sela Kastrati	
Gjuha shqipe në planet dhe programet mësimore të Kosovës	61
Gentiana Shahini	
Qasje gjinokritike ndaj teksteve letrare-artistike në arsimin fillor sipas kritikës feministe anglo-amerikane	65
Gëzim Xhambazi & Agim Sallmani	

The influence of ecological education on the development of ecological awareness of the student	69
Lulzime Lutfiu Kadriu	
Mbivlerësimi i arsyes në filozofinë perëndimore dhe pasojat e saj në lidhje me diversitetin	73
Merlina Koseni (Pograzha)	
Njeriu si subjekt dhe objekt edukimi nga këndvështrimi Islam	78
Naser Ramadani	
Arsimimi i shqiptarëve në prag të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe në periudhën e shtetit të pavarur të Maqedonisë	83
Zeqirja Rexhepi	
Intercultural education in the context of Macedonia	88
Ibish Kadriu, Buniamin Memedi, Kushtrim Ahmeti	
Interferimet letrare perso-shqiptare analizë krahasimtare mbi shembullin e rrëfimit kuranor të Jusufit dhe Zelihasë	91
Adnan Ismaili	
Kaligrafia/husn-i hatti & shprehje e përjetimit të brendshëm	98
Metin Izeti	
Pedagogjia kritike dhe zhvillimi i mendimit kritik	104
Rabije Murati, Makfirete Ameti, Agim Sallmani, Agnesa Besimi	
Zhvillimi i arsimit të lartë pedagogjik në Kosovë (1958-1990)	107
Sefedin Rahimi	
Arsimi i integruar ndëretnik dhe zhvillimi i aftësive ndërkulturore	112
Ibish Kadriu, Sermijete Xhaferi, Miranda Xhaferi	
Kurrikula në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Kosovë	116
Shqipe Krasniqi Kastrati	
Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve	120
Valdete Rrudhani Terziu, Lavdim Terziu	
Raporti mes perceptimit të stileve të leadershipit dhe vlerave orientuese individualizëm dhe kolektivizëm	127
Zana Miftari – Reka	

Ndikimi i metodës mësimore të demonstrimit në arritjet e nxënësve në mësim

Bujar Adili¹, Buniamin Memedi²

¹bujaradili74@gmail.com

²Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, Maqedoni. buniamin40@hotmail.com

Abstract

The study investigated the impact of demonstration method of teaching on students' achievement in primary education in Tetovo area of Macedonia. Two research questions and one hypothesis guided the study. A sample of 5 school heads, 100 teachers and 54 primary school students was used. For the purpose of research, instrument used included questionnaires. Research questions and the hypothesis were answered using Pearson's chi-squared test at $p < 0.05$ level of significance. The result of study revealed that demonstration method had significant effect on students' achievement than those taught with the conventional lecture method. Useful recommendations such as: efforts should be made by teachers to thoroughly integrating demonstration method in the teaching; efforts should be intensified by teachers to aggressively adopt demonstration method in teaching in all classes at the primary school level were proffered.

Keywords: Method of demonstration, students' achievement, educational process

Hyrje

Aplikimi i metodave mësimore e bën të realizueshëm dhe të efektshëm procesin edukativ dhe arsimor. Në këtë kontekst, metoda mësimore e demonstrimit është një ndër më të rëndësishmet. Vetëm në saxe të pasqyimit të botës së jashtme, te nxënësit formohen me sukses konceptet dhe fjalët. Të treguarit e shkaqeve ose provave, duke shpjeguar ose duke i bërë të qarta përmes përdorimit të shembujve ose eksperimenteve – ky është demonstrimi. Demonstrimet shpesh ndodhin kur nxënësit e kanë të vështirë që të lidhin teorinë me praktikën, ose kur nxënësit nuk janë në gjendje të kuptojnë aplikimin e teorive (Child, 1988). Demonstrimi është një qasje thelbësore e mësimdhënies në mbështetje të të mësuarit të një shkathtësie në cilindo nivel apo klasë dhe është më mbështetës nga të gjitha qasjet e mësimdhënies (Cambourne, 1988; Mooney, 1990 sipas Duke, 2007). Mësuesit demonstrojnë jo vetëm konceptet specifike mësimore brenda klasës, ata gjithashtu mund të marrin pjesë në klasa demonstruese për të ndihmuar në përmirësimin e strategjive të tyre të mësimdhënies, të cilat mund ose nuk mund të jenë të demonstrueshme në natyrë. Edhe pse literatura është e kufizuar, studimet (p. sh., Ajoke, 2012; Daluba, 2013; Adekoya dhe Olatoye, 2011) tregojnë se efektet e mësuesve që demonstojnë në klasë përfshijnë një ndryshim të perspektivës në relacion me nxënësit, më shumë reflektim në strategjitë e tyre të mësimdhënësve në klasë dhe më shumë përgjegjësi personale në të mësuarit e nxënësve. Të mësuarit të bazuar në demonstrim është procesi i përfitimit të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve (NjShQ) nëpërmjet të shikuarit të shembujve të performimit (Rosen M. A. et al, 2010). Wilson e përshkruan këtë si “një vend ku nxënësit mund të punojnë së bashku dhe të mbështesin njëri-tjetrin pasi ata përdorin një shumëllojshmëri të mjeteve dhe burimeve të informacionit në përpjekjen e tyre për arritjen e qëllimeve të të nxënësve dhe aktiviteteve të problemzgjdhjes” (Wilson, 1995). Duch (2002) e përshkruan strategjinë e demonstrimit si një strategji të mësimdhënies e cila sfidon nxënësit “të mësojnë se si të mësojnë,” të punojnë bashkë në grupe për të kërkuar zgjidhje të problemeve të botës reale.

Sfondi teorik i metodës mësimore të demonstrimit

Demonstrimi zakonisht përdoret për t'i prezentuar një shkathtësi të re një grupi të tërë, por ai mund dhe duhet të zbatohet për individë apo grup të vogël sa herë që nevojitet më shumë mbështetje për të mësuarit e tyre (Gross, 1993). Sipas Chikuni (2003), ekzistojnë dy lloje të demonstrimit: demonstrim hap pas hapi dhe demonstrim i tërë procesit. Soroka, Hoagland dhe Mohale (1977) pohojnë se i tërë procesi i demonstrimit u mundëson nxënësve që të kenë një pamje të qartë të procesit. Për Gwarinda (1993) demonstrimi hap pas hapi bëhet fazë pas faze me shpjegimin e mësimdhënësit të çdo veprimi gjatë rrjedhës së operacionit. Chikuni (2003) poashtu vë në dukje se demonstrimi hap pas hapi zë vend kur procesi prezantohet në faza të cilat ndërpriten nga pjesëmarrja e nxënësve. Metoda e demonstrimit i referohet llojit të metodës së mësimdhënies në të cilën mësuesi është aktori kryesor ndërsa nxënësit shikojnë me qëllim për të vepruar më vonë (Hinchliff, 1992). Këtu mësuesi bën atë që nxënësit pritet ta bëjnë në fund të mësimit duke u treguar atyre se si të bëhet kjo dhe duke u shpjeguar procesin hap pas hapi (Ameh, Daniel dhe Akus, 2007). Mundi (2006) e përshkroi atë si një shfaqje ose një ekspozim që zakonisht bëhet nga mësuesi, ndërsa nxënësit shikojnë me interes të madh. Ai më tej shton se, ajo përfshin të treguarit se si funksionon diçka apo hapat e përfshirë në proces. Disa nga përparësitë e kësaj metode siç nënvizon Olaitan (1984) dhe Mundi (2006) përfshijnë: Kursen kohë dhe lehtëson ekonominë materiale; metoda është një tërheqës vëmendjeje dhe një motivues i fuqishëm në ofrimin e mësimit; nxënësit marrin feedback të menjëhershëm nëpërmjet produkteve të tyre; jep një situatë të vërtetë të jetës së kursit të studimeve pasi nxënësit fitojnë aftësi në situata të jetës reale duke përdorur mjetet dhe materialet; ndihmon për të motivuar nxënësit kur kryhet nga mësuesi të aftë dhe është e mirë në të treguarit e mënyrave të duhura për të bërë gjërat. Demonstrimi mund të përdoret për të siguruar shembuj që përmirësojnë cilësinë e ligjëratave, mundësitë e të mësuarit të bazuar në kërkim në klasa ose laboratorë. Përdoret në klasat e të gjitha madhësive, në klasë dhe lëndë të ndryshme. Sipas Eley, M. dhe Norton, P. (2004) shumica e nxënësve posedojnë një stil eksravert dhe sensitiv - kognitiv. Prandaj, nxënësit më shumë vlerësojnë shembujt "Këtu dhe tash" se sa ato që janë "atje dhe atëherë" (Grasha, 2002). Demonstrimet provohen si të vlefshme në mësimdhënien e informacionit abstrakt duke siguruar metafora hapsinore për strukturën logjike. Shumë autorë kanë vënë në pedestal metodat e bërjes së prezentimeve grafike të strukturave të zakonshme të informacionit, të tilla si krahasimi dhe kontrasti, hapat procedurale, përshkrimi, kauzaliteti dhe kronologjia (p.sh., Jones, Pierce dhe Hunter, 1989). Chamberlain dhe Kelly (1981) theksojnë se një mësues i dijshtëm është ai i cili është në gjendje të ndryshojnë strategjitë mësimore. Këto mund të përfshijnë diskutime në grup, metodën e ligjërimit dhe metodën e demonstrimit. Në funksion të kësaj, Zvobgo (1990) përshkruan se mësuesit duhet të jenë në gjendje për të përmbushur nevojat individuale arsimore të nxënësve të tyre. Siyakwazi dhe Siyakwazi (1999) theksojnë se, në mënyrë që mësuesit të konsiderohet kompetentë në një lëndë, ata duhet të kenë njohuri të thella të fushës e mësimdhënies dhe duhet të kenë marrë trajnim të veçantë. Mësuesit duhet ta kenë lëndën në gishtërinjtë e tyre. McKee et al., (2007) vënë në dukje se një mësues i ditur është ai i cili ka një kuptim të plotë të stilit të të mësuarit për secilin nga stili i nxënësit ose mënyrat e prezantimit në mënyrë që metodat që do të përdoren do të kujdesen për dallimet individuale. Linhard, Dlamini dhe Bernard (1985, f.13) pohojnë se mësuesi duhet të "mësojë nga e njohura në të panjohurën." Pra, të mësuarit duhet të përparojë nga ajo që tanimë dihet nga nxënësit në diçka që është e re dhe sfiduese. Mkandla (1996) pohon se mësuesit janë të inkurajuar për të dhënë mësim edhe në qoftë se burimet janë të pamjaftueshme ose nuk ofrohen fare duke improvizuar kudo që është e nevojshme për të prezentuar dijet e tyre nga lënda.

Qëllimi dhe pyetjet e kërkimit

Qëllimi i studimit ishte që të përcaktojë ndikimin e metodës mësimore të demonstrimit në raport me metodën konvencionale të ligjërimit në arritjet e nxënësve në mësim në zonën e Tetovës, Maqedoni. Dy pyetje kërkimore drejtuan kërkimin:

1. A ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm në arritjet e nxënësve duke përdorur metodën mësimore të demonstrimit në raport me metodat konvencionale të ligjërimit?
2. A ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm në akceptimin e metodës së demonstrimit në raport me metodat tradicionale të ligjërimit?


Një zero hipotezë në nivel signifikance 0.05 është parashtruar si vijon:

Nuk ekziston dallim i rëndësishëm në arritjet në mësim ndërmjet nxënësve që mësojnë me metodën e demonstrimit dhe të atyre që mësojnë me metodat tradicionale të ligjërimit.

Metoda e kërkimit

Dizajni i studimit është konceptuar në mënyrë që të diferencohet dhe vërtetohet ndikimi i metodës mësimore të demonstrimit në arritjet e nxënësve në mësim në krahasim me metodat konvencionale të ligjërimit në një zonë të kufizuar territoriale të Tetovës në Maqedoni. Mostra përfshiu 159 respondentë (mësues dhe nxënës). Për qëllime të kërkimit, instrumenti përfshiu pyetësorë të strukturuar për nxënës dhe mësues. Pyetjet për nxënës përmbanin përgjigje opcionale të shkallës nga: pak, aspak, pjesërisht, plotësisht dhe përgjigje opcionale të kategorizimit. Pyetjet për mësues përmbanin opsione më të komplikuar me qëllim të shmangies së subjektivizmit në raport me preferencat e tyre lidhur me një metodë të caktuar mësimore. Për t'u përgjigjur në pyetjet dhe hipotezën e kërkimit është përdorur Korelacioni i Pearson-it në nivel signifikance $p < 0.05$ në shkallë lirie $Df=1$ me dy variabla A (korrespondon me metodën e demonstrimit) dhe B (korrespondon me metodat tradicionale të ligjërimit) me ç'rast variabla B nuk është parcializuar në disa nëvariabla që korrespondojnë me metoda të ndryshme konvencionale dhe si e tillë ngushton diferencën statistikore me variablën A por jo në masë të refuzimit supozimeve paraprake teorike.

Pyetja e kërkimit 1. A ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm në arritjet e nxënësve duke përdorur metodën mësimore të demonstrimit dhe metodat konvencionale të ligjërimit?



Grafiku 1. Arritjet e deklaruara të nxënësve me metodën e demonstrimit dhe metodat konvencionale të ligjërimit.

Grafiku 1 tregon se nxënësit kanë deklaruar arritje më të larta kur mësuesit kanë zbatuar metodën mësimore të demonstrimit. Një total prej 57.50% në favor të tri metodave tjera tregon për ekzistencë të mësimi të verbalizuar në këtë mjedis por nëse mënjanohet diskutimin si metodë të avansuar mësimdhënieje, atëherë mbetet që ligjërimit dhe leximi të kenë një pjesëmarrje reale pothuaj aq sa dhe diskutimi. Kjo implikon që nxënësit kanë arritje më të larta në mësim nën aplikimin e demonstrimit në mësimdhënie nga mësuesit në krahasim me metodat konvencionale të ligjërimit përjashtuar këtu diskutimin si metodë mësimore. Pra, nxënësit kanë dhënë indikacione të qarta për preferencat e tyre lidhur me llojin e metodës mësimore më të pranueshme. Edhe gjetjet nga studimi i Ameh dhe Dantani (2012) tregojnë se nxënësit performojnë më mirë në Kimi kur mësojnë duke përdorur metodën e demonstrimit krahasuar me metodën e ligjërimit.

Tabela 1. Të ariturat në mësim si rezultat i zbatimit të metodës së Demonstrimit

Të ariturat në mësim si rezultat i zbatimit të metodës së Demonstrimit	N100	N%
Të shkëlqyeshme	36	36%
Shumë të mira	39	39%
Të mira	25	25%
Të dobëta	/	0%

Në pyetjen nëse Demonstrimi ndikon në të ariturat në mësim, vërehet se 36% dhe 39% nga mësuesit pohojnë se të ariturat në mësim janë të shkëlqyeshme dhe shumë të mira respektivisht.

Pyetja e kërkimit 2 A ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm në akceptimin e metodës së demonstrimit në raport me metodat tradicionale të ligjërimit?

Tabela 2. Niveli i kuptueshmërisë së përmbajtjes mësimore në raport me mjetet mësimore

Niveli i kuptueshmërisë së orës mësimore	Plotësisht	Pjesërisht	Pak	Aspak
Përmbajtja mësimore ku mësuesi përdor vizatime, fotografi, skica, për mua është e kuptueshme	80%	18%	2%	0%
Përmbajtja mësimore ku mësuesi përdor film, televizion, radio për mua është e kuptueshme	49%	41%	5%	5%
Përmbajtja mësimore ku mësuesi përdor kompjuter dhe projektor për mua është e kuptueshme	67%	24%	5%	4%
Përmbajtja mësimore ku mësuesi përdor libra dhe fletë pune për mua është e kuptueshme	72%	18%	6%	4%
Kur mësuesi e vizaton atë që e shpjegon unë e kuptoj	81%	17%	2%	0%

Të dhënat nga tabela më lartë tregojnë për një akceptim më të lartë të metodës së demonstrimit të realizuar nëpërmjet mjeteve mësimore në dispozicion në krahasim me metodat konvencionale të ligjërimit. Gjetjet nga studimi i Ajoke (2012) tregojnë se nxënësit që mësojnë duke përdorur qasjen demonstruese nxënës-mësues performojnë më mirë se ato që mësojnë duke përdorur qasjen demonstruese mësues-nxënës.

Hipoteza

Nuk ekziston dallim i rëndësishëm në arritjet në mësim të nxënësve që mësojnë me metodën e demonstrimit dhe të atyre që mësojnë me metodat tradicionale të ligjërimit.

Tabela 3. Tabela e diferencës së arritjeve të nxënësve që mësojnë me metodën e demonstrimit dhe me metodat konvencionale të ligjërimit

data: contingency table			expected: contingency table		
	A	B		A	B
1	16	4	20	14.4	5.56
2	23	11	34	24.6	9.44
	39	15	54		
chi-square = 0.958			X ² =0.958		
degrees of freedom = 1			df=1		
probability = 0.328			p=0.328		

Korelacioni i Pearson-it tregoi se zero hipoteza e parashtruar refuzohet që do të thotë se ekziston dallim i rëndësishëm në arritjet në mësim të nxënësve që mësojnë me metodën e demonstrimit dhe të atyre që mësojnë me metodat tradicionale të ligjërimit. Nxënësit që mësojnë me metodën mësimore të demonstrimit tregojnë arritje më të larta në krahasim me ata që mësojnë me metodat konvencionale të ligjërimit.

Gjetjet

Analiza e rezultateve solli në gjetje të tilla si: Arritjet e nxënësve duke përdorur metodën mësimore të demonstrimit janë më të larta në krahasim me metodat konvencionale të ligjërimit; Metoda e demonstrimit ka një pranueshmëri të lartë te nxënësit; Ekziston dallim i rëndësishëm në arritjet në mësim të nxënësve që mësojnë me metodën e demonstrimit dhe të atyre që mësojnë me metodat tradicionale të ligjërimit.

Diskutim i gjetjeve

Nxënësit treguan rezultate më të mira nën një mësimdhënie të drejtuar nga mësues që aplikojnë metodën e demonstrimit. Kompetenca e mësuesit tregon një nivel jo të duhur të përgatitjes për aplikim të demonstrimit. Mungesa e mjeteve mësimore të nevojshme për një implementim sistematik të kësaj metode në mësimdhënie, lejon orientimin

e mësuesve nga metodat konvencionale të ligjërimit. Shumica e nxënësve janë shprehur që përmbajtjet mësimore janë më të kuptueshme gjatë përdorimit të mjeteve audio-vizuale të treguarit si dhe shumica e mësuesve dhe drejtuesve pohuan që shkollat posedojnë mjete të mjaftueshme mësimore të demonstrimit. Rezultatet e studimit tregojnë se ekziston një përqindje e lartë e mësuesve (afër 30%) që nuk e zbatojnë metodën e demonstrimit në mësimdhënie. Nxënësit performojnë më mirë dhe arrijtjet janë më të larta por ekziston një përqindje e lartë e tyre (mbi 30%) që e kanë më të pranueshme metodën konvencionale të ligjërimit. Rezultatet implikojnë që ekzistojnë praktika të tejkaluara, jotëdobishme dhe mangësi në zbatimin e kësaj metode. Gjetjet treguan që nuk ka dallim të rëndësishëm ndërmjet femrave dhe meshkujve në arrijtje dhe se performimi i tyre varet edhe nga faktorë tjerë përpos aplikimit të metodave mësimore. Rezultatet e studimit nga Adekoya dhe Olatoye (2011) treguan se strategjia e demonstrimit solli ndryshimin më të rëndësishëm në të arriturat e nxënësve. Nxënësit në grupin e strategjisë së demonstrimit ishin më të motivuar për të mësuar; kjo mund të jetë si rezultat i mundësisë për të bashkëvepruar me mësimdhënësin dhe poashtu të bëjnë pyetje në një mjedis miqësor. Gjetjet e studimit nga Daluba (2013) tregojnë që nxënësit që mësuan shkencën bujqësore me metodën e demonstrimit ($x = 66,57$) kishin rezultatet më të larta mesatare në fazën pas trajtimit të të arriturave se sa ata që mësuan me metodën konvencionale të ligjërimit ($x = 61,47$).

Përfundim dhe rekomandime

Nxënësit e arsimit fillor nga klasa V-VIII tregojnë performim të ndryshëm kur mësojnë me metodat konvencionale të ligjërimit dhe me atë të demonstrimit. Performansa e tyre ishte më e mirë pas të mësuarit me anë të metodës së demonstrimit. Përfundimisht, ekziston dallim i rëndësishëm në arrijtjet e nxënësve që mësonin me metodën e demonstrimit dhe metodën konvencionale të ligjërimit.

Duke u bazuar në gjetjet dhe përfundimin e studimit, parashtrihen këto rekomandime:

1. Mësuesit e arsimit fillor duhet të dekurajohen nga zbatimi i metodave konvencionale të ligjërimit pasi nxënësit tregojnë performansë më të dobët;
2. Duhet të bëhen përpjekje nga mësuesit për të integruar tërësisht metodën e demonstrimit në mësimdhënie;
3. Duhet të intensifikohen përpjekjet nga mësuesit që në mënyrë agresive të aplikojnë metodën e demonstrimit në mësimdhënie në të gjitha klasat në nivel të shkollës fillore.
4. Autorët e librave duhet të konsiderojnë si prioritare përfshirjen në tekstet e tyre zbatimin efektiv dhe aplikimin e metodës së demonstrimit në procesin edukativ dhe arsimor.
5. Autoritetet arsimore dhe qeveria duhet të bëjnë kërkime tjera mbi efektivitetin e metodës së demonstrimit në aspekte të tjera të procesit mësimor.

Referencat

- [1] Ameh, I-Ei, Daniel, B. P., & Akus, Y. (2007). *Research and Methods in the Social Sciences*. Anka: Rowis press.
- [2] Adekoya, Y. M. and Olatoye, R.A. (2011). "Effect of Demonstration, Peer-Tutoring, and Lecture Teaching Strategies on Senior Secondary School Students' Achievement in an Aspect of Agricultural Science". *Pacific Journal of Science and Technology*. 12(1):320-332.
- [3] Ajoke, A. A. (2012). Creativity and Process Skills for Self-Reliance Using Demonstration Approach of Teaching Chemistry. *ARPJ Journal of Science and Technology*. VOL. 2, NO. 11, pp. 1029-1033.
- [4] Chamberlain, V.M. and Kelly K.M. (1981). *Creative Home Economic Instruction*. USA, Mac Grow Hill lank.
- [5] Child, D. (1988). *Psychology and the Teacher*. London: Cassel press.
- [6] Chikuni, B. (2003) *The Teachers Handbook. A practical approach to Teaching*. Gwanda: Flame Publishers.
- [7] Daluba, N. E. (2013). Effect of Demonstration Method of Teaching on Students' Achievement in Agricultural Science. *World Journal of Education* Vol. 3, No. 6; p. 5.
- [8] Duch, B. (2002). "Problem-based Learning". Published by University of Delaware, Retrieved on 15th January, 2014 at <http://www.udel.edu/pbl>
- [9] Duke, A. M. (2007). Performance-based assessment within a balanced literacy framework: an analysis of teacher perceptions and implementation in elementary classrooms.
- [10] Eley, M. & Norton, P. (2004). The Structuring of Initial Descriptions or Demonstrations in the Teaching of Procedures. *International Journal of Math Education, Science, and Technology*. 35(6), p. 843-866.
- [11] Gross, M.U.M. (1993). *Exceptionally Gifted Children*. London: Routledge. Gwanda, Flame Publishers.

- [12] Grasha, A. F. (2002). Teaching with style. San Bernadino: Alliance Publishers.
- [13] Gwarinda, T. C. (1993) The Practice of Education. Bulawayo: R.C.P Belmont Press.
- [14] Hinchliff, S. (1992). The Practitioner as a Teacher, London: Scutari Press. Harare, College Press.
- [15] Jones, B. F., Pierce, J., & Hunter, B. (1989). Teaching students to construct graphic representations. *Educational Leadership*, Dec. 88/Jan. 89, 20-25.
- [16] Linhard, N., Dlamini, N. and Barnard, W. (1989). Guidance in the Classroom. Cape Town. Maskew Millerhang (Pvt) Ltd.
- [17] McKee, E., Williamson, V. M., and L. E. Ruebush, L. E. (2007). Effects of Demonstration Laboratory on Student Learning. *Journal of Science Education and Technology*. 16.5, pp. 395- 400.
- [18] Mkandla, V.A. (1996). Professional Studies, Getting the Job Done. Bulawayo, College Desktop.
- [19] Mundi, N. E. (2006). The state of students' academic achievement in secondary school agricultural science in Kogi State. *Teacher Education Journal (TEJ)*, 12(1), 14-19.
- [20] Olaitan, S. O. (1984). Agricultural Education in the Tropics – Methodology for Teaching Agriculture. London: Macmillan Publishers.
- [21] Soroka, D. S. Hoagland, C.W. and Mohale, A.M, (1977) Micro teaching in Africa. Maseru: Mazonod Institute.
- [22] Paul, O. A. and Dantani, Y. S. (2012). Effects of Lecture and Demonstration Methods on the Academic Achievement of Students in Chemistry in Nassarawa Local Government Area of Kano State. *International Journal of Modern Social Sciences*, 2012, 1(1): 29-37
- [23] Rosen, M. A. et al. (2010). Demonstration-Based Training: a Review of Instructional Features. *Human Factors*, Vol52, Part: 14: pp.596 - 609
- [24] Siyakwazi, B., & Siyakwazi, P. D. (1999). Strategies in Teaching and Learning. Southern African Regional Institute for Policy Studies (SARIPS). African Books Collective, Ltd., The Jam Factory, 27 Park End Street, Oxford, OX1 1HU, England, United Kingdom.
- [25] Wilson, B. G. (1995). Metaphors for instruction: Why we talk about learning environments. *Educational Technology*.52 (5), pp. 25 – 30.
- [26] Zvobgo, C. J. (1990). Education and employment of the blind in Zimbabwe, 1981-1987.